

Kerkese per informacion nga Shoqata "Qatar Charity"

Gjatë periudhës Janar- Korrik 2022 në Zyrat e Punësimit u shpallën 23,229 vende të lira pune (VLP) ose 84% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Sipas Aktiviteteve ekonomike rreth 41% e VLP-ve të shpallura ishin në industrinë përpunuese, 14% në tregti, 13% në akomodim dhe shërbim ushqimor, 7% në ndërtim, 4% në shërbime administrative dhe mbështetëse, dhe 21% në aktivitete të tjera ekonomike.

Profesionet më të kërkuara në këto VLP janë: rrobaqepës, këpucar, punonjës në industri të tjera përpunuese, operator në shërbimin Call Center, punonjës në fushën e ndërtimit, kamarier, banakier, sanitar, agjent shitjesh, dhe specialist me arsim të lartë me profil ekonomik, juridik dhe mjekësor.